




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot No.
2-D/DPK	01-1794/13
Nr. i faq. / Broj stranica / Nr. pages	Data / Datum / Date
02	11-06-2013
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **04.06.2013**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

***I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-439/13 për z. Ilir Hajdari – Drejtor i buxhetit dhe financave në administratën qendrore të Universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.***

### A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-439-13, për Zyrtarin e lartë, z. Ilir Hajdari – Drejtor i buxhetit dhe financave në administratën qendrore të Universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-439/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Hajdari së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-810/13), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z.Hajdari është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z.Hajdari në Agjenci ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-1631/13), në të cilën shihet se z.Hajdari ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte te N.P.SH.“Geli”, për të ushtruar funksionin e tij publik si Drejtor i buxhetit dhe financave në Universitetin e Prishtinës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

